



## Vuajtja si dorëzim

### Description

Hamza Jusuf

*Dhe Ne do t'ju sprovovmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, po ti jepju myzhde durimtarëve – ata që kur i godet ndonjë e pakëndshme thonë: “Të Zotit jemi dhe tek Ai do të kthehemi!” Të tillët janë ata që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë.*

Kuran 2:155-157

#### Bare Oak Tree Image and name unknown

Kurani ka një mori ajetesh që kanë si trajtesë natyrën e botës, përfshirë provat dhe sprovat e saj, aq sa të krijohet ideja, nëpërmjet këtyre ajeteve, Kurani dëshiron që të na përgatisë që të presim fatkeqësi dhe vuajtje të atilla që do të na shkundin nga gjumi i shkujdesur i përditshmërisë sonë të qetë. Pritshmëritë tona përcaktojnë reagimet që ne do të kemi ndaj vuajtjes që hasim gjatë jetës sonë mbi tokë, dhe kuptimi që ne mbrujmë për realitetin e kësaj bote, por dhe dorëzimi ynë ndaj realitetit të Zotit, përcaktojnë pritshmëritë tona në këtë dynja.

Në ajetin e mësipërm, kur Zoti thotë “Dhe Ne me të vërtetë do t'ju vëmë në provë” (*ue la-nebluennikum*), ky faktikisht është një njoftim – ajo çka komentuesit e kanë përkufizuar një paralajmërim (*indhara*). Proverbi arab “Ai që ka dhënë një paralajmërim, i ka larë duart” (*men endhere a'dhere*) duket se është mëse i qëlluar. Kështu pra, ne duhet të presim atë për të cilën po paralajmërohemi: pa dyshim, një miriadë fatkeqësish do të na pllakosin gjatë jetës sonë. Belaja, apo mundimi (*bela*), është në zemër të jetës, dhe Kurani na rrëfen se s'ka dyshim që Zoti i lartësuar do të na vërë në provë.

Sprova e parë ka të bëjë me frikën. Frika është universale, është një dukuri e natyrshme e konditës tonë njerëzore; në fakt, emocioni i parë që fëmija përjeton kur vjen në këtë botë është pikërisht frika – prandaj janë dhe ai vështrimi i tmerruar dhe ato të qarat plotë frikë nga i sapolinduri derisa nëna e përqafton foshnjën në gjirin që rrezaton siguri. Përgjatë gjithë jetës, ne të gjithë, pa dallim, kemi për ta përjetuar frikën: frikën se mos humbasim punën, frikën se mos na vdes një njeri i zemrës, frikën nga

ngelja në provim apo nga dështimi në një sipërmarrje a tregti. Madje edhe pejgamberët, të cilëve pa dyshim nuk kishin mangësi në guxim, kanë përjetuar frikë. Për shembull, Kurani thotë se Musai, paqja qoftë mbi të, ndjeu frikë në zemër (20:67). Frika na mbron nga guximi prej kokëkrisuri dhe marrëzia. Dhe vërtet, sikurse ka thënë Alexander Pope në thënien e tij të famshme, “Atje ku ëngjëjt kanë frikë të shkelin, të marrët turren me hap të ngutur”. Guximi nuk është mungesë e frikës, por është një cilësi që na lejon ta kapërcejmë frikën që na pengon, e cila mund ta na e bëjë të pamundur që të veprojmë siç duhet kur ballafaqohemi me sprovat: zjarrfikësi i cili rend me vrap për të shpëtuar njerëzit në një ndërtesë që po digjet ka një guxim që e flak tutje frikën se mos lëndohet.

Teksa ajeti vijon më tutje, Zoti thotë se ne do të sprovohemi me uri (*el-xhu*). Duke pasur parasysh se ne jetojmë në një epokë të kornukopias, apo birit të begatisë, me një bollëk ushqimesh dhe pasurish, sidomos në pjesën më të madhe të botës perëndimore, ne shpeshherë e harrojmë se bota paramoderne, përpara ekonomisë bujqësore të industrializuar që ekziston sot, ka përjetuar shpesh periudha të burimeve të varfëra dhe madje edhe zi buke. Çuditërisht, në gjithë këtë shkapërderdhje të shoqërive moderne, ne gjithashtu dëshmojmë një masë të vogël mirënjohjeje: ne harrojmë se uria është ende e kudojendur në botën moderne.

Qytetërimet tradicionale kanë patur një kulturë mirënjohjeje – të thënies së një duaje apo lutjeje përpara se ushqimi të hahej në pjatë dhe, kur mbaronin, thuhej një “elhamdulillah” me gjithë zemër. Në disa kultura arabe, njerëzit thonin, “hajde, pastroje Medinën” (*nadhdhifu el-Medineh*), që donte të thoshte “mbaroje ushqimin në pjatë”; në disa kultura të Azisë jugore, fëmijëve u thuhet se në qoftë se e mbarojnë ushqimin në pjatë, ata do të marrin shpërblim të njëjtë si ata që pastrojnë Qabenë. Një mirënjohje e tillë zë fill te Pjegamberi, paqja dhe mëshira e Zoti qofshin mbi të, i cili kishte një nderim të lartë për bereqetet e Zotit. Shokët e tij të Nderuar kanë përcjellur se ai kurrë nuk ankohej për ushqimin; në qoftë se i vinte pas midesë, e hante, nëse jo, nuk e prekte me dorë, por ama nuk thoshte asgjë. Agjërimi, i qenësishëm për të gjitha fetë e mëdha, e bën më të lehtë vlerësimin për dhuratën e ushqimit kur njerëzia çelin iftarin; myslimanët, që agjërojnë gjatë orëve të ditës në muajin e Ramazanit, e rrokin mirë urinë, një ndjesi kjo e prekshme fizike, që sjell mirënjohje për bereqetin e ushqimit, por gjithashtu kultivon empati për ata të cilët urinë e kanë bukë të përditshme.

Man praying in Nakhoda Masjid, the principal mosque of Kolkata, India; photo: Chitragrapher / Wikir

Image not found or type unknown

Nje njeri duke u falur në xhaminë Nakhoda, Indi. Photo Chitragrapher / Wikimedia Commons

Ajeti më tutje thotë se Zoti do të na vërë në sprovë me “humbjen e pasurisë, frymëve, dhe frutave” ( *ue naksin min el-emuali ue el-enfusi ue el-themerat*). Fjala në arabisht *naks* ka shumë kuptime, njëri prej të cilëve është *humbje* apo *pakësim*. Ne do të sprovohemi, pra, me humbjen apo pakësimin e pasurisë si edhe me humbjen apo pakësimin e jetës: njerëzit humbasin kujtesën, shikimin, dëgjimin, gjymtyrët, të dashurit, miqtë, kafshët shtëpiake, dhe kështu me radhë – të gjitha këto ne i marrim si të mirëqena derisa ato të mos jenë më. Asnjë jetë nuk i shpëton këtij rregulli. Humbja në fjalë është në rrënjë të natyrës së këtij vendbanimi, dhe, duke përqafuar humbjet që ne përjetojmë përgjatë rrugës, ne mund të përftojmë urtësi të madhe. Sikurse ka shkruar Shekspiri: “Lermë të të përqafoj, o fatkeqësi, burrat e mençur thonë se ti je udha më e mençur.”

Më pas, ajetet kuranore shndërrohen në çështjen se *si* duhet të kuptojmë dhe rrjedhimisht t’u përgjigjemi sprovave të frikës, urisë, dhe humbjes së pasurisë, jetës, dhe fryteve: “Përgëzoni ata që bëjnë durim” ( *ue beshshir el-sabirin*) – domethënë, ata të cilët janë të duruar në fatkeqësi. Gjatë kohëve të fatkeqësisë, shumëkush përpiket fort që të tregojë durim. Durimi i vërtetë, siç kuptohet në traditën islame, don të thotë “të jesh i duruar në bindjen tënde dhe i duruar në të frenuarit e vetes nga rënia në mosbindje” ( *el-sabr ‘ala el-ta’ah ue el-sabr ‘an el-ma’asi*) – të frenosh veten kur ti fillon të humbasësh durimin dhe kur bie në dëshpërim. Shën Toma Akuini e vendoste durimin në mesin e virtyteve kryesore për shkak se Letra e Jakobit thotë që “durimi bën punën e tij të përsosur”. Megjithatë, njëlloj si eticistët myslimanë të virtytit përpara tij, Akuini e konsideronte atë një “bijë” të katër virtyteve kardinale. Virtyti i guximit dhe i përmbajtjes “i japin jetë” durimit, që e lejon njeriun të mbartë një barrë dhe të jetë i palëkundur në sprovë: një ushtar tregon durim dhe palëkundshmëri nëpërmjet guximit në kapërcimin e frikës në fushëbetejë. Një person i përmbajtur tregon palëkundshmëri dhe durim në të rezistuarit ndaj joshjeve. Kështu, “ata që bëjnë durim” në ajetin kuranor janë ata të cilët ruajnë palëkundshmërinë në të qenit të bindur ndaj krijuesit.

Në esenë e tij më titull “Një shkollim i rrezikshëm: si na edukon vuajtja për përjetësinë”, Kierkegaard citon Hebrenjve 5:8, që thotë se “Jezui e mësoi bindjen nga vuajtjet e tij”. Sipas Kierkegaardit, të mësuarit e bindjes nga vuajtja nuk është diçka e lehtë, por në qoftë se një njeri mënon që të mësojë bindjen, “atëherë ai mund të mësojë atë çka është më korruptuesja: të mësojë të kërkojë me ngulm dëshpërimin, të mësojë që t’i mbyllë gojën shpirtit, të mësojë të ndrydhë çdo entuziazëm të fisëm në të, të mësojë mosbindjen dhe dëshpërimin (shiko fq. 1 në këtë revistë [prej nga është marrë artikulli, sh.p.]). Kur vjen sprovë, dhe kur prej saj mësojmë bindjen, thotë Kierkegaard, ne edukohemi për përjetësinë. Kur ne tregojmë durim në bindje dhe durim në shmangien e mëkatit, atëherë mëkati, brenga, egocentrizmi, dhe keqardhja për veten, që na verbojnë nga të parit e të mirës që fshihet pas sprovës, nuk krijojnë në veten tonë një etje të paduruar e cila na verbon ne në raport me të mirën.

Në traditën islame, fatkeqësia (*ibtila*) është ëngjëlli mbrojtës që na frenon nga të rrëshkëturit në shkujdesjen dhe fragmentaritetin e botës, të cilat mund t’i hapin gropën veteve tona. Vuajtja jonë na mban në shkollë – në këtë “shkollim të rrezikshëm”, siç e quan Kierkegaard. Në qoftë se bëjmë durim në fatkeqësi dhe kemi mirënjohje në bekim, jemi të ravijëzuar vertikalisht me Zotin. Megjithatë, në qoftë se dështojmë që të ngrejmë sytë tanë drejt qiejve dhe mbetemi të ravijëzuar me botën, me dynjanë, atëherë pashmangshmërisht kuptimi ynë kaplohet nga dëshpërimi dhe shtyhem drejt thellësive të mëtejshme të dëshpërimit.

Fatkeqësisht, një dukuri fund e krye moderne dhe përherë e më e zakonshme është të ankuarit, një kundërpërgjigje egoiste e tipit “përse po më ndodh kjo gjë” ndaj fatkeqësisë, diçka që ka qenë e pazakontë në shoqëritë paramoderne dhe mbetet e rrallë në rudimentet e kulturave tradicionale sot. Dekada më parë, kur jetoja në Mauritani, shumëkush atje e merrte si të mirëqenë se unë si perëndimor kisha njohuri për mjekësinë, dhe kështu ata shpesh më flisnin për sëmundjet e tyre me shpresën se unë do t’i ndihmoja njëfarësoj. Ajo çka më linte pa fjalë ishte se ata gjithmonë i modelonin përshkrimet e tyre me shprehje të tipit si “thjesht po ju shpjegoj gjendjen time” (*hadha ‘ard hal*); “nuk po ankojem: shyqyr Zotit dhe Atij i qofshim falë” (*lejse sheuke: elhamdulilah ue el-shukru lilah*). Ajo që fshihet nën këtë shtysë është një besim i thellë e megjithatë i thjeshtë se, në thelb, ne i përkasim Zotit, dhe prandaj trupat dhe frymët tona janë të Zotit.

Lidhur me ata të cilët janë të duruar në rast fatkeqësie, ajeti kuranor thotë: “Kur vuajtja i pllakos ata ( *el-ledhine idha asabet’hum musibeh*), ata thonë, “Me të vërtetë, të Zotit jemi dhe tek Ai kthehem” ( *inne lilahi ue inne ilejhi raxhi’un*)”. Si krijesa të Zotit, ne i përkasim vetëm Zotit, dhe me ne Ai mund të bëjë çfarë të dojë. Gjetkë, Kurani thotë, “Nuk ka katastrofë që të bjerë mbi ju e të mos jetë nga Zoti” (64:11); një tjetër ajete thotë “me përjashtim të rastit kur është nga vetja juaj” (4:79). Pavarësisht nga kjo, këto dy ajete nuk shihen si kontradiktorë se ndonëse gjithçka vjen nga Zoti i Lartësuar, edukata jonë (*edeb*) në raport me Zotin është e tillë që t’ia veshim fajin vetes kur ndonjë ligështi na bie mbi krye. Shumë prej brengave tona burojnë drejtpërdrejt nga përkujdesja e gjymtuar që tregojmë ndaj pronës së Zotit: ne shpeshherë i lëmë pas dore trupat tanë, hamë ushqime të pashëndetshme, nuk bëjmë ushtrime fizike, dhe më pas i lutemi Zotit përvuajtshëm që të na japë shërim. Mirëpo, po qe se do të ishim shërbestarë të drejtë e të devotshëm të të Gjithëmëshirshmit dhe do të përkujdeseshim për jetët tona, por sërish fatkeqësitë do të na goditnin, atëherë në këtë rast këto janë sprova nga Zoti, dhe duhet t’i nënshtrohemi Atij. Në lidhje me ata që nënshtrohen dhe nuk bëjnë pyetjen “Përse po më ndodh kjo gjë?”, Zoti thotë: “Ata marrin bereqet dhe dhembshuri nga Zoti i tyre.” Zoti i bekon ata për shkak se ata janë në një gjendje durimi, që është në të vërtetë një gjendje mirënjohjeje në atë se ata e pranojnë që gjithçka vjen nga Zoti, përfshirë dhe katastrofën, dhe rrjedhimisht edhe ajo gjithashtu duhet të jetë detyrimisht e mirë.

\*\*\*

Misteri i të keqes mbetet një nga sfida më të mëdha të jetës së njeriut, një sfidë që ka ndërlytur filozofë e poetë që nga kohëra që s’mbahen mend. Ata janë përpjekur që t’i japin kuptim këtij misteri dhe shpesh kanë ofruar një udhëzim që ngre në qiell të vërtetat e marra nga profetët. Në *Moby Dick*, në një kapitull të titulluar “Praronjësi”, Melville zbulon se në thelb ne kemi tre reagime ndaj misterit të të keqes: atë të Kapitenit Ahab apo të njërit prej dy pjesëtarëve të ekuipazhit të tij, Starbak dhe Stub. Çdonjëri prej nesh zgjedh njërin prej këtyre tre reagimeve.

Në këtë fragment, Melville përshkruan rrjedhojën e lundrimeve dhe vozitjeve të gjata në det, kur Ahabi dhe ekuipazhi i tij më në fund po pushojnë dhe po çlodhen, në një mot të këndshëm, ku e vetmja gjë që shohin është horizonti i oqeanit përreth tyre, dhe në ç’mënyra të ndryshme reagon çdonjëri prej tyre ndaj kësaj skene plot madhështi e hijeshi:

Nën një diell të butë, gjithë ditën e ditës duke lundruar mbi ujëra të patrazuar që mbufaten ngadalë, ulur në varkën e tij të lehtë si një kanoe, dhe duke u përzier kaq miqësisht me vetë valët e buta, që si mace shtëpie kërmëzjnë pranë parmakut të anijes; këto janë kohëra të një qetësie ëndërrimtare, kur sodit bukurinë e qetë dhe shkëlqimin e lëkurës së oqeanit, harron zemrën prej tigri që gulçon poshtë tij; dhe nuk harron se kjo putër e kadifenjtë fsheh një çatall që s'i bren fare ndërgjegja.

Pikërisht në këto momente që, në varkën e tij me rrema, vagabondi seç ka një ndjenjë, nuk e di pse, birnore, me besim, tokësor; dhe e konsideron atë si një tokë të madhe të lulëzuar; dhe anija larg, që tregon vetëm majën e direkëve, duket se mezi avancon jo mospërmas dallgëve të larta por mospërmas barit dallgëzues të një prerie, si atëherë kur në Perëndim kuajt e pionierëve tregojnë vetëm veshët e ngrehur drejt, dhe trupat e tyre të fshehur hapin një tablo të mrekullueshme me gjelbërim.

Luginat e virgjëra të hapura, anët e kodrave në të kaltër të lehtë, ndërsa mbi gjithçka shtrihet heshtja, zukama; do të betoheshit se fëmijë të lodhur nga loja dremisin në këto vetmi, në ndonjë maj të lumtur, kur mblidhen lulet e pyjeve. Dhe e gjitha kjo shkrihet me gjendjen tuaj më mistike, aq sa realiteti e fantazia, duke u takuar në mes të rrugës, gërshetohen dhe i japin trajtë një tërësie unike.

As këto skena lehtësuese, sado efemerale, nuk mënojnë që së paku të prodhojnë një efekt po aq kalimtar mbi Ahabin. Por ndonëse këto çelësa sekretë të artë dukej se po i hapnin në kraharor thesaret e fshehta e të arta, megjithatë gulçima që ai i hodhi sipër tyre vetëm sa ua humbi shkëlqimin.

Oh lëndina me bar ! Oh peizazhe të paskajta të pranverës së përjetshme të shpirtit! Tek ju, ndonëse prej kohësh të thara nga thatësira e vdekur e jetës tokësore, tek ju njerëzit mund të kridhen si mëza të rinj në tërfillin e mëngjesit, dhe për disa çaste arratiake, ndjejnë mbi vete vesën e njomë të jetës së pavdekësisë. Ah sikur Zoti të donte që këto prehje të bekuara të mos reshtnin. Por në gërshetimin e tyre të ndërsjellë pejzat e jetës janë lidhur nga shtrembërimi dhe thurja: qetësi të përshkuara nga stuhira, një stuhi për çdo qetësi. Nuk ka progres të ndalur dhe të pakthyeshëm në këtë jetë; nuk avancojmë me etapa të fiksuara drejt pushimit të fundit: drejt magjisë së pandërgjegjshme të foshnjërisë, besimit kuturu të djalërisë, dyshimit të rinisë (fatkeqësi e përbashkët), e më pas drejt skepticizmit, e më pas mosbesimit, për t'u ndalur në fund, të pjekur, në prehjen e menduar të një Ndoshta. Jo, kur të mbërrijmë në fund e bëjmë edhe një herë këtë rrugë, dhe jemi përjetësisht fëmijë, djelmosha, burra dhe Ndoshta. Ku është porti i fundit nga i cili nuk do të nisemi më kurrë? Në cilin eter të dalldisur lundron bota, nga e cila ata të sfilliturit nuk lodhen kurrë? Ku fshihet babai i foshnjës së gjetur në rrugë? Frymët tona janë si ata jetimë të cilëve nënat e pamartuara u vdiqën gjatë lindjes: sekretet e atësisë sonë shtrihet në varrin e tyre, dhe është aty që duhet ta kërkojmë atë sekret.

Dhe në po të njëjtën ditë, edhe Starbaku, me vështrimin e kredhur poshtë nga ana e tij e varkës mbi po të njëjtin det të praruar, murmuriti me zë të ulët: "Bukuri e parrokshme, që një i dashuruar e pa në vështrimin e nuses së re! Mos më flit për peshkaqenët e tu me dhëmbët mprehur, dhe për mënyrat e tua kanibaleske prej grabitësi. Lëre besimin të flakë tutje faktet; lëre fantazinë të flakë kujtesën; unë vështroj këtë thellësi dhe besoj."

Dhe Stubi, si peshk, me luspa vezulluese, brofi mbi atë nur të praruar:

"Unë jam Stubi, dhe Stubi ka historinë vet; por këtu, Stubi betohet që ka qenë gjithnjë gazmor!"

Me reagimet e këtyre tre personazheve mitike ndaj panoramës së detit në rrezet e diellit që frymëzon drojë, Melvil rrok mjaft qartë totalitetin e reagimeve njerëzore ndaj bukurisë së shkëlqyer të botës së natyrës. Ahabi, skeptiku konfliktual, mund të besojë në një krijues të padukshëm nëqoftë se ditët e tij do të ishin gjithnjë të lavdishme sa ajo ditë e qetë, e prehur, dhe e paqetë teksa ai hedh vështrimin mbi oqeanin e gjerë, të shirë dhe të qetë. Por sprovat e tmerrshme të botës – përfshirë edhe humbjen e këmbës nga një balenë gjigante që e bëri atë t'i jepej kërkimit të hakmarrjes – e mbushin mendjen e tij me dyshim dhe obsesion. Besimi në mendjen e hidhëruar të Ahabit përfaqëson pafajësinë e një nxënësi të vogël i cili më vonë do të përballet me realitetet tragjike të jetës. Përgjigja e tij i ngjason asaj të Hamletit të Shekspirit në stadin e tij të hershëm (Melvili e njihte shumë mirë këtë tragjedi), kur Hamleti vë në diskutim kuptimin e jetës ose pakuptimësinë e saj në monologun e tij të famshëm “Të jesh a të mos jesh”. E megjithatë, ndryshe nga Hamleti, i cili e zgjidh krizën e tij aty nga fundi i veprës tragjike me kuptimin se “të qenit gati është gjithçka”, Ahabi ngelet një skeptik i pandreqshëm.

Ottoman capitulation at Nikopol in Russo-Turkish War, Nikolai Dmitriev-Orenburgsky, 1883

Image not found or type unknown

Kapitullimi osman në Nikopol gjatë luftës turko-ruse, Nikolai Dmitriev-Orenburgsky, 1883

Starbaku, njëlloj si Hamleti në fazën e tij të fundit, vështron të njëjtin oqean si kapiteni i tij, dhe pavarësisht nga tufanët, shtrëngatat, dhe stuhitë e jetës, ai zgjedh të besojë. Ai pikas diçka më të thellë se trazirat dhe hutimet e jetës mbi tokë. Në bukurinë dhe madhësinë e lavdishme të aktit krijues, dyshimet dhe faktet trazonjëse nga eksperiencat e jetës së tij, që kërcënojnë e besimin e tij, zmbropsen, dhe ai e lë “besimin që të flakë tutje faktet”, duke i mundësuar kështu vetes që të shohë dorën e providencës.

Dhe në fund, ne kemi Stubët e kësaj bote, ata të cilët janë të burgosur nga egot e tyre, të cilët janë të paaftë për shumëçka krahas rendjes pas kënaqësive momentare, dhe nuk shohin asnjë kuptim përtej botës materiale, nuk mendojnë se ka asgjë që të jetë më e madhe se jeta e tyre. Stubi është narcizi i ulët e i përbuzur i cilin rron vetëm për veten: si peshk me luspat e tij vezulluese, ai deklaron, “unë jam Stubi”, dhe ekzistencën e tij si peshk e jeton ngjashëm me atë si të gjedhëve të atyre që nuk janë mësuar me detin.

Këto tri moduse të të qenit rrinë for mirë në linjë me tre tipet e njerëzve të përmendur në fillim të kapitullit të dytë të Kuranit, nga i cili janë marrë ajetet e parashtruara në fillim të kësaj eseje: mosbesimtari (Stubi), që Zoti përshkruan në vetëm dy ajete; besimtari (Starbak), që Zoti e përshkruan në vetëm katër ajete; skeptiku, i luhaturi, i cili endet ndërmjet besimit dhe mosbesimit (Ahabi), që Zoti e përshkruan me trembëdhjetë ajete. Sasia e fjalëve që Melvil përdor për të përshkruar secilin prej këtyre

tre personazheve çuditërisht është e ngjashme me masën e fjalëve që Zoti përdor për të përshkruar këto tre arketipe.

Në *Vëllezërit Karamazov* të Dostojevskit, katër vëllezërit merren me të njëjtin problem: misterin e ligësisë. Mbasi filozofia nihiliste e Ivanit vihet në jetë nga studenti i tij Smerdjakovi, Ivani kupton të vërtetën tragjike të një bote pa Zot. Prandaj, ligësia, vetë ky koncept, bëhet argumenti më i madh për ekzistencën e Zotit. Sepse mirësia morale, e cila përcakton ligësinë, mund të ekzistojë vetëm nëse ka një Zot. Dostojevski i rikthehet kësaj teme pareshtur. Për besimtarin, ligësitë e botës zgjidhen duke pasur një kuptim rreth natyrës së botës, sikurse na kujton Emili Dikinson: “Bota nuk është konkluzion./ Një specie qëndron përtej / e padukshme si muzika / por pozitive si tingulli.” Ligësitë e botës kanë kuptim vetëm kur njeriu kupton se bota nuk është konkluzion: po vjen një ditë kur borxhet do të shlyhen. Kur të mbërrijë gjyqi i fundit, çdo qen do të ketë hesapin e vet, njëlloj edhe çdo burrë e çdo grua.

Për këtë arsye, besimtari i sheh të gjitha ngjarjet e botës si të mira për shkak se ato janë krijime të aktualizuara të Zotit. Dimensionin e tyre moral – zinxhiri i ngjarjeve që çojnë në një ngjarje të veçantë dhe zinxhiri i ngjarjeve që është filluar nga po kjo ngjarje e veçantë – nuk rroket dot nga intelektin njerëzor. Kjo nuk do të thotë se nuk mund të ndajmë të drejtën nga e gabuara: kjo do të thotë vetëm që ne nuk mund ta gjykojmë këtë nga ajo që mund të hamendësojmë për vetë ngjarjen në fjalë. Më saktë, gjykimin përfundimtar duhet t’ia lëmë Zotit dhe duhet të kemi besim te mirësia e gjykimin për shkak se vjen nga Zoti. Vetëm Zoti sjell mirësi nga e keqja, dobi nga dëmi, dhe jetë nga vjekja. Kjo është arsyeja përse ajetet që u përmendën në fillim të kësaj eseje përfundojnë me “Ata janë të udhëzuarit në rrugë të drejtë”. Ata janë të udhëzuar në rrugë të drejtë për shkak se ata e kuptojnë që misteri i ligësisë është i padepërtueshëm nga inteligjenca jonë e natyrshme, sepse nevojitet një gjunjëzim i mendjes sonë (*sexhde* në kuptimin islam) para inteligjencës së mbinatyrshme. Ky nuk është besim pa arsye: ky është besim i arsyeshëm i injektuar me një vetë-evidencë të mbinatyrshme që transhendon evidencën e jetës së natyrshme.

Në një hadith të mrekullueshëm të përcjellur nga Suhej Rumi, dhe që gjendet në përmbledhjen e famshme të haditheve të titulluar Sahihu i Muslimit, Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Sa e mrekullueshme është puna e besimtarëve; me të vërtetë, e gjithë puna e tyre është mirësi. Dhe kjo është e vërtetë vetëm për besimtarët. Kur atyre u jepet një bekim, ata janë mirënjohës, dhe ai [bekimi] ka qenë i mirë për ta. Dhe në qoftë se ata i godet diçka e dëmshme [fatkeqësi, sëmundje, humbje e pasurisë], ata tregojnë durim. Dhe, ajo [diçka e dëmshme] ka qenë më e mirë për ata.”:

Në thelb, ky hadith shpreh frazën e mirënjohur “gjithçka është mirësi”, një gjendje e përshquajtjes shpirtërore, dhe një frazë që është e vërtetë. Shumë njerëz sot, sidomos në komunitetin e afro-amerikanëve, i thonë këto fjalë për të treguar pranimin e sprovave, të mëdha apo të vogla qofshin ato, pranimin e realitetit metafizik që çfarëdo që ndodh *ka qenë shkruar të ndodhte*: “Gjithçka është mirësi!” Hadithi në thelb thotë se në qoftë se ti je besimtar, atëherë gjithçka është mirësi! Madje edhe dëmi është mirësi për shkak se tek ai ka një urtësi (*hikmeh*) që për ne mund të jetë e panjohur.

Sprovat nuk janë vetëm vështirësi apo katastrofa natyrore që na ndodhin, siç është pandemia COVID-19; siç thotë Ahmed Zarruku “Një person është një sprovë për veten e tij apo të saj”, dhe ne mund të jemi sprovë për të tjerët.

Muslim Cemetery in Ottoman City Trebizond, Evgeny Evgenievich Lancere, 1917

Image not found or type unknown

Varreza myslimane në qytetin osman Trebizond, Evgeny Evgenievich Lancere, 1917

Zoti thotë: “Ne i kemi privilegjuar një pjesë prej jush karshi të tjerëve, dhe në amshim ka privilegje më të mëdha [se në tokë]” (17:21). Kështu, kur ne shohim dikë që është në një gjendje të privilegjuar, pyetja që duhet bërë duhet të jetë kjo: A po e përdorin ata privilegjin për mirë apo për keq? Kurani thotë: “Ne i bëmë një pjesë prej jush sprovë për të tjerët; a do të tregoni durim? Dhe Zoti juaj sheh gjithçka” (25:20) . Në lidhje me këtë ajet, teologu i shekullit të katërmëdhjetë Ibn Kajjim el-Xheuzije ka thënë se Zoti i ka bërë skamnorët sprovë për pasunarët dhe pasunarët sprovë për skamnorët; Ai e ka bërë të paditurin sprovë për të diturin, dhe të diturin sprovë për të paditurin; dhe kështu me radhë. Kjo është bota ku ne po rrojmë; pyetja përfundimtare që shtrihet përpara nesh është nëse mund ta pranojmë, dhe, nëpërmjet pranimit, t’i nënshtrohemi realitetit të Zotit, apo do të ngelim injorantë (*xhahil*)

Nocioni se qeniet njerëzore mund të jenë një sprovë për qenie të tjera njerëzore është ngërthyer në një aforizëm sekular të shekullit të njëzet “Ferri është gjithë njerëzit e tjerë”. Megjithatë, ky aforizëm nuk e rrok tamam tamam thelbin e problemit. Në librin e tij të famshëm të shekullit të pesëmbëdhjetë *Kaua'id el-tesavuf* (Parimet e Sufizmit), Sidi Ahmed Zarruk jep parimin e 165: “Unikaliteti i Zotit, më i larti në përsosmërinë e Tij, përcakton vendosjen e papërsosmërisë te kushdo tjetër përveç Zotit.” Me fjalë të tjera, Zoti është unik në përsosmërinë e tij, kështu që gjithçka tjetër është e mangët. Përsosmëria nuk është e qenësishme te qeniet njerëzore: kur ne shohim papërsosmëri, mangësi, dhe dobësi tek njerëzit e tjerë, ne shohim natyrën e tyre, e cila, falë faktit se ata janë të krijuar, përmban potencialin e përsosmërisë, por përsosmëria mund të bëhet realitet vetëm nëpërmjet mëshirës së Zotit, Sidi Ahmed Zarruk më tutje thotë: “Kështu, nuk do të mund të gjesh dot një njeri të përsosur, nëse Zoti nuk e ka përsosur atë, dhe nëse nuk është i përsosur nëpërmjet mëshirës së Zotit”. Për shembull, përsosmëria e Pejgamberit është nga përsosmëria e Zotit, diçka që Zoti e ka dhënë nga mirësia (*fadl*) e tij.

Sidi Ahmed Zarruk më tej thotë: “Të kërkuar përsosmërinë në ekzistencë bazuar mbi themelin e saj të papërsosmërisë është vanitet, kotësi”. Prandaj, është pa dyshim papjekuri, në mos gabim, që të presësh nga bashkëshortja/i apo nga fëmija, pa folur për institucionet, entitetet, dhe qeveritë, që të jenë të përsosura. Bota e përsosur është parajsja (*xheneti*). Vendi ku ne rrojmë quhet *dynja*: dynjaja është vendi më i ulët në univers, një vend ku ne lëmë pas ndytësinë tonë duke kërkuar udhën e dëlirësimit. Nga këtu fillon ngjitja. Madje edhe njerëzit në ferr janë në një gjendje të përkujtimit të Zotit (*dhikr*) dhe në një gjendje të pendimit dhe keqardhjes për veprimet e shkuara, me dëshirën që ata të kishin qenë të drejtë dhe të mos e kishin çuar dëm jetën e tyre.

Sidi Ahmed Zarruk thotë: “Për shkak të kësaj, është thënë që krijimi duhet të vështrohet me syrin e përsosmërisë, por në esencat e krijesave duhet qëmtuar papërsosmëria.” Me fjalë të tjera, ai na këshillon që të shohim me sytë e Starbakut, jo me ato të Ahabit apo Stubit: kjo shpie drejt një aftësie me anë të së cilës tregohesh i mirë me njerëzit dhe mbruan një opinion të mirë për ta. “Dhe nëpërmjet kësaj,” thotë ai, “njeriu është i aftë që të mbrojë veten dhe që të ruajë gjykimin e mirë, bashkëjetesën e përhershme, dhe mungesën e preokupimit për gabimet apo të metat e të tjerëve.”

Sidi Ahmed Zarruk e përfundon parimin e tij të 165-të me një citim nga Imam Xhunejdi, i cili e lidh drejtpërdrejt kuptimin tonë të papërsosmërive të njerëzve – dhe të botës sonë – me një parim që do të bënim mirë ta kishim parasysh:

“E kam bërë aksiomë dhe që nga ai çast më ka mundësuar që ajo çka më brengos nga kjo botë të mos më trazojë në asnjë moment”. Cili është ky parim, kjo e vërtetë themelore? “Dhe aksioma në fjalë është kjo: se vendbanimi i kësaj bote është një vendbanim i stresit, dëshpërimit, sprovës, dhe mosmarrëveshjes. Dhe kjo botë – e gjitha – është e mangët (*sherr*).” Ndërkohë që *sherr* ndonjëherë kuptohet se don të thotë “e keqe”, në të vërtetë ajo i referohet “të qenit i mangët apo nevojtar”. Arabët e quajnë varfërinë *sherr* për shkak se nëse jemi nevojtarë, atëherë ne na mungon pasuria. Kjo bota, kjo dynja, është një vendbanim i mangësisë, lidhur me të cilën Imam Xhunejdi më tutje thotë: “Natyra e saj është e tillë që ajo do të më vërë mua përballë gjithçka që unë urrej, dhe në ndodhtë që ajo më ndesh me atë çka dua, kjo është thjesht mëshirë e begatë. Dhe nëse jo, atëherë natyra e saj është siç thashë më sipër.”

Bota, dynjaja, na paraqet vuajtje, dhe në qoftë se përjetojmë kohëra që nuk përmbajnë sprovë të tilla

në këtë vendbanim të sprovave, ato kohëra vijnë vetëm falë mëshirës së Zotit. Një botëkuptim i tillë është në linjë me katër të vërtetat fisnike të Budizmit: vuajtja dhe pangopësia janë karakteristika të natyrshme të ekzistencës mbi tokë, dhe burimi i vuajtjes është pikërisht dëshira dhe nepsi ynë, atashimi ynë me botën. Siç thuhet në esenë e Kierkegaard-it, ne duhet t'i largohemi botës nëpërmjet vuajtjes, njëlloj si ai fëmija që qan kur i hiqet gjiri i nënës. Heqja e gjirit buron nga kuptimi se fëmija duhet të ecë përpara në stadin tjetër të jetës. Në fund, ne do të merremi me forcë nga kjo botë kur të vdesim. Ndërkohë, të rritesh do të thotë të heqësh dorë nga gjiri i dynjasë, dhe vuajtja bën të mundur shkëputjen tonë nga një vendbanim prej të cilit duam s'duam duhet të largohemi, qoftë nëse e pranojmë këtë lirisht me një britmë hareje apo qoftë nëse i nënshtrohemi asaj plot keqardhje me një klithje dëshpërimi.

Në traditën islame, fatkeqësia (*ibtila*) është ëngjëlli mbrojtës që na frenon nga të rrëshkiturit në shkujdesjen dhe fragmentaritetin e botës, të cilat mund t'i hapin gropën veteve tona.

Ne shkurajohemi dhe vuajmë kur kemi pritshmëri që nuk përmbushen nga realitetet e botës dhe njerëzit e saj. Por në qoftë se e shohim këtë botë si një vend ku Zoti do të na vërë në sprovë me frikë dhe uri, me një humbje apo pakësim të pasurisë e jetës, dhe në qoftë se tregohemi të duruar me angushtitë e dhimbshme dhe jemi mirënjohës për bekimet e begata, atëherë ne do të jemi edhe më të lumtur për ato zgjedhje.

Pejgamberi (a.s.) ka qenë gjithnjë pozitiv dhe ka qenë në paqe me vendbanimin e tij; kjo është arsyeja përse sprovat dhe vuajtjet e panumërta që ai përjetoi nuk e cënuan asnjëherë shpirtin e tij. Ai qëndronte gjithnjë në syrin e uraganit. Zoti ka krijuar uraganin, por ai gjithashtu ka krijuar dhe syrin e uraganit. Në qoftë se jemi në syrin e uraganit, turbullirat që shtillen përreth nesh nuk kanë për ta trazuar gjakftohtësinë tonë. Uragani është kjo botë, kjo dynja, por syri i uraganit është portë e përtejesisë që mëshira na e ka dhuruar nëse zgjedhim që gjithçka, të mirat dhe të këqijat, t'i shohim se burojnë nga një krijues i dashur e i mëshirshëm. Të qenit në syrin e uraganit don të thotë ta pranosh botën, ta pranosh dynjanë, siç është – ky tufan i stuhishëm e i llahtarshëm që bart plot mirësi, mirësia e së cilës qëndron në të qenit e saj – dhe të marrësh pjesë me hare në plotësinë e saj, në shuarjen e saj rrëzëllëse që është jeta në tokë. Në kohën e shkurtër që na është caktuar në këtë planet, ne mund të zbulojmë (literalisht, të heqim perden) Zotin, i cili është i fshehur ndërkohë që ne e kemi para syve. Kjo është përgatitje – *gjithë puna është të jesh gati* – për një rikthim te Zoti. Dhe vërtetë, në çdo fatkeqësi apo brengë që na pllakos, le të kujtojmë se “Me të vërtetë të Zotit jemi dhe tek Ai do të kthehemi”.

Përktheu: Arjol Guni

**Date Created**

25/02/2021

**Author**

hamza-yusuf